

Rektori mashtrues dhe heshtja intelektuale

Në kohën kur vendi ynë sfidohet me probleme për krijimin e një shoqërie demokratike dhe përparimtare, me rend, ligj dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, një shembull me interes për diskutim dhe studim është Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP). Në fakt, vet ne, stafi akademik i UP-së, do të duhej ta studionim më shumë veten.

Asnjë studim, e sidomos studimi i vetvetes, nuk mund të bëhet pa guxim intelektual. Po ashtu, studimi nuk guxon të jetë i heshtur apo të mos ballafaqohet me opinionin shkencor dhe publik. Prandaj, sot po shkruaj për një lajm që u publikua rishtazi në “Kohën Ditore”, dhe që përbën një rast tragjik të abuzimit të pozitës nga kreu i UP-së dhe vardisjes ndaj tij të anëtarëve të një Komisioni. Fjala është për avancimin e jashtëligjshëm të rektorit Gashi.

Fatkeqësisht, siç dihet mirëfilli, në UP ka pasur raste të shumta të keqpërdorimeve dhe mashtrimeve, që e kanë lëkundur reputacionin e institucionit më të rëndësishëm arsimor në Kosovë. Këto raste janë parë si pjesë e një dukurie më të gjerë shoqërore dhe shpesh është ngritur zëri, por edhe më shpesh është heshtur.

Se përmasat e kësaj të keqeje janë alarmante dëshmon edhe fakti se rektori paska tentuar të na mashtrojë me punimet e tij fals në një revistë fals. Rektori nuk është anëtar i vetëm i komunitetit tonë që bën gjëra të tilla, por edhe pse disa ishin në pritje që ai do t'i luftonte dukuritë joetike, si duket ai vetë i viktimizon normat etike dhe statutare në UP, për interesa personale.

Ja faktet, të cilat u dhanë në “Kohën Ditore”:

Në Buletin Nr. 7, dt.9.7.2013, komisioni treanëtarësh (S. Daci, G. Rizaj dhe K. Kaser) vlerëson se *“kandidati Ibrahim Gashi ka cilësi brilante [...] dhe propozon të zgjedhet Profesor i rregullt (Prof. dr.)”*. Ata më heret rendisnin pesë punime “me impact factor” të Rektorit (aq sa kërkohen në Statut të UP-së), tri prej të cilave janë të botuara në 2012 dhe dy të tjera më herët.

Tri punimet e vitit 2012 në fakt janë botuar në prill të vitit 2013. Ato janë botuar në të njëjtin numër në Revistën Ndërkombëtare të Inxhinierisë dhe Shkencave Menaxhuese (International Journal of Engineering and Management Sciences, IJEMS). Pas konsultimit me disa kolegë (seriozë) historianë, ata më siguruan që punimet nga fusha e historisë zakonisht nuk botohen në revista për inxhinieri dhe menaxhim. Për më shumë, vet publikuesi i revistës IJEMS, “Science and Nature”, cilësohet si “i rremë, fals, jolegjitim dhe tallës”.

Nga dy punimet e tjera, njëri nuk është fare punim i botuar në revistë shkencore, kurse tjetri është pjesë e një libri, që me zemërgjerësi po ia numërojmë si kontribut shkencor.

Lëre që tri punimet e cilësuar si kryesore nuk janë punime nga fusha e historisë (“Mineralet dhe menaxhimi i tij [sic]”, “Privatizimi dhe sfidat e ardhshme në ekonominë

e tregut të lirë”, “Sfidat e menaxhimit të integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian”), por ato nuk janë aspak shkencore. Një perlë e vërtetë është paragrafi i fundit i pjesës së Konkludimit, në punimin në lidhje me BE (fjalë për fjalë nga anglishtja):

“Pra, mund të konkludojmë se Kosova e ka adoptuar për përdorim Euron, pastaj është pranuar së fundi në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim – BERZH, është njohur nga 22 shtete evropiane, dhe formalisht të gjitha 27 vendet e ka[në] zotuar që të mos vendosin asnjë pengesë në pranimin në asociacione të ndryshme. Ne jemi në Evropë dhe i kemi përmbushur dhe jemi në proces të përmbushjes të shumë kushteve për pranim në bashkim. Pra, mund të themi se është impertive edhe për dobinë ekonomike dhe politike që Kosova të integrohet në Evropë”.

Njëri nga anëtarët e komisionit, i cituar në artikullin e "Kohës Ditore", thotë se gjykimi i publikimeve është “çështje shkencore [...] e jo publicistike gazetareske”. Por nuk ka nevojë të jesh studiues i shkencave humane e sociale të gjykosh se “konkludimi” i cituar më lartë nuk përmbush as kriteret më bazike të argumentimit shkencor. Ironia trashet kur komisioni vlerësues e cilëson kandidatin Ibrahim Gashi si “pionier në fushën e studimeve të historisë bashkëkohore dhe të studimeve të historisë së diplomacisë”. Punimet me “impact factor” të përmendura nga komisioni vlerësues as që kanë të bëjnë me historinë bashkëkohore dhe të studimeve të historisë. Ajo që e bën pionier Rektorin Gashi – por dhe komisionin e tij vlerësues – është përdorimi i një logjike të paprecedent në një institucion serioz që atyre ua bën të mundur të konkludojnë se punimet me tema si “Mineralet dhe menaxhimi i tij” paraqesin “kontribut të çmueshëm në historiografinë shqiptare”.

Në artikullin e "Kohës Ditore" përmendet po ashtu se rektori Gashi ka dhënë si arsye mungesën e interesimit ndërkombëtar për temat që trajtojnë studiuesit kosovarë dhe faktin se të njëjtin problem e kanë të gjithë profesorët e rregullt të UP-së. Së pari, duhet përmendur se ka mjaft studiues të huaj, por dhe disa kosovarë, përfshirë edhe historianë, që kanë publikuar në revista legjitime për tema që trajtojnë Kosovën. Së dyti, është absurd që rektori, i cili më së shumti do të duhej të angazhohej ta zgjidhte problemin e publikimeve të dyshimta nga profesorët e UP-së, t’i arsyetojë publikimet e tij të rreme me faktin se edhe të tjerët po bëkan njësoj. UP-së i nevojitet një rektor që ka autoritetin dhe guximin intelektual e moral t’i zgjidh problemet e mëdha që e kanë kapluar këtë institucion, jo një që e shfrytëzon ekzistencën e këtyre problemeve për ta justifikuar mashtrimin dhe avancimin e tij personal.

E pra, është imperative që rektori i UP-së, dr. Ibrahim Gashi, të kërkon falje dhe tërhiqet nga pozita, se përndryshe i tërë Universiteti i bëhet i remë, fals, jolegjitim e tallës. Udhëheqjen e tij nuk e meriton komuniteti ynë akademik e aq më pak shoqëria jonë. Nëse nuk jep dorëheqje, atëherë strukturat e UP-së duhet ta largojë “pionierin” e mashtrimin në UP.

Për fund, disa shënime shtesë, sepse nuk do mend se ka interesim për këtë “afërë”. Unë mendoj se do të ishte shumë në rregull që nganjëherë, kur kanë merita të larta në mësimdhënie (edhe pse nuk do ta preferojë këtë praktikë), edhe ata që kanë dhënë kontribut modest shkencor të avancoheshin në profesorë të rregullt në UP. Tekefundit, ne

jemi vet një institucion modest për kah dija. Po ashtu, numri i punimeve ose vendi ku janë publikuar ato nuk është busulla më e saktë e përcaktimit të cilësisë dhe rëndësisë shkencore të një veprimtarie. Por, dija modeste dhe mashtrimi sypatrembur dallojnë shumë. Nuk duhet të biem pre e revistave të rreme (që nënkupton një nivel mediokriteti të pafalshëm për një studiues serioz), por mbi të gjitha, mashtruesit e kapur në flagrancë duhet t'i dënojmë publikisht dhe pa rezerva për dëmin e pariparueshëm që po i bëjnë UP-së dhe shoqërisë. Kjo nuk kërkon guxim intelektual. Kjo përbën obligim intelektual.